


# UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” MITROVICË



ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË




## Raport përmbledhës për pyetësorët e realizuar me studentët.

NIVELI MASTER  
(Semestri dimëror)

Shkurt, 2021


**Përmbajtja**

<b>Lista e shkurtesave</b> .....	<b>3</b>
<b>Hyrja</b> .....	<b>4</b>
<b>Zyra për Sigurim të Cilësisë</b> .....	<b>5</b>
<b>Realizimi i pyetësorit</b> .....	<b>5</b>
<b>Gjetjet e pyetësorit</b> .....	<b>6</b>
<b>Rekomandimet</b> .....	<b>16</b>



## Lista e shkurtesave

<b>IAL:</b>	<b>Institucion i Arsimit të Lartë</b>
<b>KQSCV:</b>	<b>Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit</b>
<b>SEVC:</b>	<b>Sistemi Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë</b>
<b>SMU:</b>	<b>Sistemi i Menaxhimit Universitar</b>
<b>UIBM:</b>	<b>Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë</b>
<b>ZSC:</b>	<b>Zyra për Sigurim të Cilësisë</b>



## Hyrja

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (këtu e tutje: UIBM), si Institucion i Arsimit të Lartë (Këtu e tutje: IAL) themeluar që nga viti 2013, vazhdimisht ka bërë përpjekje që të bëjë të matshëm procesin e sigurimit të cilësisë. Për çdo vit, në UIBM janë organizuar pyetësorë me studentët dhe akterë tjerë relevant, të cilët janë përgjegjës në pyetjet të cilat kanë pasur për qëllim të tregojnë gjendjen reale në UIBM përmes përceptimit të respondentëve.

UIBM ka mekanizmat e tij për matjen e cilësisë, dhe përveç që procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ana e dekanëve, prodekanëve, koordinatorëve për cilësi në kuadër të fakulteteve, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (Këtu e tutje: ZSC) ka një rol të veçantë në këto zhvillime, dhe është organi kryesor brenda UIBM për matjen e cilësisë së brendshme.

Në muajin Janar 2021, në vazhden e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda UIBM, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në UIBM, përmirësimit të mësimdhënies si një proces vazhdimisht i ndryshueshëm përkitazi me metodologjitë e reja, dhe rritjes së përgjegjësisë së stafit menaxhues, ZSC-ja ka realizuar pyetësorin me studentët e UIBM, në nivelin Master, në përfundim të semestrit dimërorë, si një proces tashmë i zakonshëm.

I gjithë procesi i hartimit të pyetësorëve, lansimit të tyre dhe i mbledhjes së të dhënave është bërë nga ZCS-ja në koordinim të plotë me KQSCV-në. Procesi ka qenë transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë qenë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur prestigjin e institucionit.

Më poshtë do të paraqesim të dhënat që janë nxjerrë nga pyetësori. Me qëllim që raporti të ruaj etikën e secilit dhe atë të institucionit, do të gjeni të publikuara vetëm disa nga gjetjet kryesore të pyetësorit. Rekomandimet si pjesa e fundit e tij, do të përmbajnë edhe sugjerime e vërejtje të cilat nuk bëhen publike, por që janë dhënë nga ana e respondentëve.

### Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC)

Zyra për Sigurim të Cilësisë është zyrë e pavarur e cila funksionon brenda Rektoriatit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (tutje UIBM) e cila raporton drejtpërdrejt te Rektori i UIBM-it. ZSC angazhohet në rritjen e cilësisë në UIBM duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentat matës të cilësisë të aprovuar nga Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit (tutje KQSCV). Zyrtarët e cilësisë nuk janë pjesë e stafit akademik të UIBM-it.

Zyra kryen matje të cilësisë duke përdorur të gjitha instrumentet e përfshira në pakon e instrumenteve matëse të cilësisë e aprovuar nga KQSCV. ZSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilën pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Rektori i UIBM-it. Zyra gjithashtu i dërgon gjetjet dekanëve të njësive akademike me qëllim të planifikimit të zhvillimit të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.



## Realizimi i pyetësorit

Pas përfundimit të ligjëratave dhe ushtrimeve për semestrin dimëror 2021, ZSC ka lansuar pyetësin me të gjithë studentët e nivelit Master në të gjitha programet, nga data 05 Janar deri me 16 Janar 2021. Pyetësi ka qenë anonim dhe të dhënat janë mbledhur dhe ruajtur nga ZSC përmes Sistemit Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë - SEVC. Studentët janë përgjigjur përmes Sistemit të Menaxhimit Universitar (tutje SMU) në pyetësin i cili ka përmbajtur 13 pyetjet të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur, ku kanë vlerësuar programi i studimit dhe mbështetja në punën hulumtuese.

Pyetësi ka qenë i ndarë në dy nivele:

- Programi i studimit dhe
- Mbështetja në punën hulumtuese

Pyetjet kanë pasur për qëllim që të shohin këto aspekte kryesore:

- Kurrikula e programit
- Zhvillimi i mendimit kritik
- Punimi i diplomës
- Konsultimet me mentorin dhe kontributi i tij;
- Qasjen e mësimit ndaj studentëve;
- Metodën e mbajtjes së mësimit online;
- Rezultatet e të nxënit.



### Gjetjet e pyetësorit

Pyetësori është plotësuar nga të gjithë studentët që kanë paraqitur provimet në afatin e rregullt të provimeve.

Nga të gjeturat studentët kanë qenë të sinqertë në përgjigjet e tyre, dhe kemi pranuar shumë komente dhe sugjerime që tregojnë interesimin e tyre që të kontribuojnë në proceset në UIBM.

Ky raport shprehë vetëm statistikat e përgjithshme, dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e përgjigjeve. Ndërsa, raportet për fakultetet veç e veç, si dhe për secilin profesor, ZSC-ja i ka dërguar tek Dekanët e fakulteteve, dhe ata do t'i diskutojnë gjetjet me stafin e tyre akademik.


Në pjesën e parë të pyetësorit është trajtuar programi i studimit ku studentët kanë dhënë vlerësimin e tyre rreth këti dimensionit.

Studentët janë deklaruar 79% se kurrikulumi i ofruar nga departamenti përkatës i ka përgatitur për tregun e punës në mënyrë të kënaqshme dhe 75% janë deklaruar se programet ofrojnë zhvillim shumë të madh të menduarit kritik.


Për pjesën teorike 70% mendojnë se teoria ka qenë mirë e ndërlidhur me orët e ushtrimeve apo punët praktike që i kanë zhvilluar dhe 76% mendojnë se programi i studimit ka përmbushur shumë pritshmëritë fillestare të studenteve.

Manuali i punimit të diplomës është cilësuar si shumë ndihmesë e madhe (77%) për përpilimin e temës së Masterit

**1. Kurrikulumi i ofruar nga departamenti po më përgatit për tregun e punës.**




**2. Studimet në këtë program më kanë zhvilluar mendimin kritik.**







**3. Teoria ishte shumë e ndërlidhur me orët e ushtrimeve apo punët praktike që i kemi zhvilluar.**



**4. Në ç'masë programi i studimit ka përmbushur pritjet tuaja fillestare?**



**5. A ju ka ndihmuar manuali i punimit të diplomës në përpilimin e temës së Masterit?**



Ne pjesën e dytë, pyetësi ka përmbajtur pyetje që lidhen me mbështetjen në punën hulumtuese të studentëve ku kanë dhënë vlerësimet e tyre.


Studentët janë shprehur se 74% e tyre kanë pasur hulumtime kërkimore në të gjitha lëndët dhe 73% janë shprehur që qasja e mentorëve ka qenë e mirë për të diskutuar për temat e hulumtuara.

Studentët kanë vlerësuar shumë se raporti me mentorët është i mirë dhe në shumicën e rasteve apo 83% ju janë kthyer përgjigje nga ana e tyre. Po ashtu 83% kanë deklaruar se procedurat në UIBM janë të qarta dhe e lehtësojnë përzgjedhjen e punimit të Masterit.


Studentët janë deklaruar se 39% e tyre realizojnë 3-4 konsultime në muaj me mentorin rreth temës së diplomës, 27% e tyre realizojnë mbi 7 konsultime në muaj, 20% realizojnë 5-6 konsultime në muaj dhe 14% realizojnë 1-2 konsultime në muaj dhe 83% e tyre deklarojnë se qasja e mentorëve është e lehtë dhe korrekt.

89% e studenteve kanë deklaruar se do të regjistroheshin në të njëjtin program përsëri dhe 88% e studenteve kanë deklaruar se do të ua rekomandonin të tjerëve këtë program.


6. Kemi pasur punë hulumtuese/kërkimore në të gjitha lëndët.




7. Sa ka qenë mundësia të kontaktoni me mentorin për punimin master online?




8. A ju janë ofruar informatat kthyesse adekuate nga mentori përmes platformës online të UIBM?




9. Komunikimi me mentorin ka qenë i lehtë dhe korrekt.




10. Procedurat administrative e lehtësojnë përzgjedhjen dhe punimin e Masterit.




11. Sa ka qenë shpeshtësia e konsultimeve me mentorin?.



**12. Nëse do të mund të zgjidhnit tani, a do të regjistroheshit në të njëjtin program përsëri?**



**13. Duke pasur parasysh përvojën tuaj, a do të rekomandonit këtë program studimi për të tjerët?**



14. Çfarë ndryshimesh do të sugjeronit me qëllim të përmirësimit të cilësisë së përgjithshme të programit të studimit?

**Komente:**

- Literaturë më e re për tu përshtatur me zhvillimet globale.
- Mundësi për kryerjen e praktikave nga bashkëpunimet e universitetit me institucione dhe ndër marrje të ndryshme.
- Mungesa e literaturës shtesë për lëndët.
- Praktika të jetë obligative para përfundimit të studimeve.
- Mundësi bashkëpunimi me stafin akademik për punime shkencore;
- Ushtrime laboratorike më të shumta
- Të krijohet sa më shumë hapësirë për punë të pavarur kërkimore – shkencore, duke lidhë marrëveshje bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit;
- Integrimi i lëndëve mësimore në lidhje me ideimin dhe optimizimin e bioreaktoreve dhe optimizimin e reaktoreve.
- Të shtohet lënda e Gjeometrisë;



### Rekomandimet

Zyra e cilësisë e UIBM, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e studentëve të nivelit Master në këtë pyetësor, dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të UIBM që të merren hapat si më poshtë:

- Të kërkojë nga menaxhmenti i njësive akademike përditësimin e literaturave për lëndët që i mbajnë stafi akademik.
- Të krijohen mundësi nga stafi akademik për realizmin e punimeve të përbashkëta hulumtuese me studentët;
- Të investohet vazhdimisht në literatura për mbulimin e lëndëve që janë sipas planprogramit.
- UIBM të nënshkruaj sa më shumë marrëveshjeve bashkpunimi për punë hulumtuese dhe praktike për studentët master;
- Fokusimi i studentëve tek puna praktike dhe shfrytëzimi i aparaturave që posedojnë njësitë akademike.
- Të analizohet nevoja e lëndëve të reja: Gjeometira, Reaktorët dhe Bioreaktorët